



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 99
Prishtinë, më 7.5.2024, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Hykmete Bajrami, Arta Bajralija, Bekim Arifi, Halil Thaqi, Mirlinda Tishukaj-Sadiku, Visar Korencia, Albana Bytyqi, Rashit Qalaj, Yllëza Hoti

Munguan: Hajdar Beqa dhe Adem Hoxha.

Stafi mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj.

Pjesëmarrësit e tjerë: Bashkim Pllana dhe Riza Spanca, nga KRU Prishtina, Myrvete Gashi Morina, Samir Zymberi dhe Driada Thaqi, nga ZKA, Erona Retkoceri, praktikante në Kuvend.

Mbledhjen e kryesoi: Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 17.4.2024;
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të performancës “Sistemet e Informacionit në Kompaninë e Ujësjiellit Rajonal Prishtina”;
4. Shqyrtimi i Raportit të përbashkët në auditimin paralel – “Sistemet e Informacionit në Ujësjiellit e Tiranës dhe Prishtinës”.
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 17.4.2024

Procesverbali u miratua pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të performances “Sistemet e Informacionit në Kompaninë e Ujësjetës Rajonal Prishtina”. Të ftuar: Bordi i KRU-së;

Hykeme Bajrami, kryetare e komisionit: Të nderuar të pranishëm, po fillojmë mbledhjen e sotme të Komisionit për Mbikqyrjen e Financave Publike. Pika e tretë e rendit të ditës është Shqyrtimi i Raportit të auditimit të performancës “Sistemet e Informacionit në Kompaninë e Ujësjetës Rajonal Prishtina”, dhe kemi një auditim paralel për, KRRU-të e dy kryeqyteteve, Tiranën dhe Prishtinën. Për shqyrtimin e këtyre raporteve, të ftuar e kemi Bordin e KRU Prishtina dhe ekipin e Auditimit nga ZKA-ja. Deputete raportuese kemi znj. Mirinda Tishukaj- Sadiku.

Mirlinda Tishkuaj- Sadiku: Faleminderit kryetare, përshëndetje për ju kolegë, media, përfaqësues të KRU Prishtina, ZKA. Është e vërtetë që i kemi dy raporte, por fokusi im do të jetë te Sistemet e Informacionit në Kompaninë e Ujësjetës Rajonal Prishtina. Po ashtu, ZKA-ja, ka bërë një auditim paralel me Kontrollin e lartë, të Shqipërisë dhe rekomandimet janë të njëjta. Ky auditim është bërë për të vlerësuar, nëse strukturat udhëheqëse të ndërmarrjes kanë siguruar se burimet e teknologjisë informative mbështetin qëllimet dhe strategjinë e ndërmarrjes, duke ofruar një mjedis efektiv për ta ruajtur integritetin e të dhënave dhe vazhdimësinë e sistemit të TI-së. Ky auditim ka mbuluar gjendjen aktuale të TI-së në ndërmarrjen publike KRU Prishtina, ndërsa në kontrollet e aplikacioneve për të dhënat hyrëse është testuar gjendja aktuale e aplikacioneve, si dhe janë verifikuar të dhënat e regjistruara gjatë viteve 2021/22 dhe në vijim do të paraqes të gjeturat, të cilat i ka dokumentuar ZKA-ja.

Qeverisja e TI-së në Kompaninë Rajonale të Ujësjetës Prishtina nuk ka rezultuar të jetë efektive. Mungon planifikimi strategjik i TI-së, politikat dhe procedurave si dhe nuk ka vendosur strukturë organizative adekuate dhe të plotë duke rrezikuar mospërdorimin efektiv të burimeve për arritjen e objektivave të ndërmarrjes, prandaj në mungesë të efektivitetit dhe informacionit, KRU Prishtina nuk ka procedurë për identifikim dhe specifikim të kërkesave apo nevojat e TI-së dhe nuk ka plan të detajuar me të gjitha kërkesat apo nevojat e TI-ve. Ndërmarrja nuk ka planifikim strategjik të TI-së, i cili përkthen objektivat e biznesit me qëllime dhe kërkesat e teknologjisë, dhe adreson burimet e nevojshme për të mbështetur ndërmarrjen. Po ashtu, KRU Prishtina nuk ka strukturë të plotë organizative dhe ndarje të qartë të detyrave dhe përgjegjësive, kur është vërejtur se ndër vite ka pasur ndryshime të vazhdueshme në departament të TI-së, sa i përket pozicionimit dhe raportimit. Po ashtu, divizioni i TI-së nuk i ka të plotësuara të gjitha pozitave e parapara me rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendit të punës, si dhe nuk ka ndarje të qartë të detyrave dhe përgjegjësive në fushën e TI-së. Ndryshimet e vazhdueshme në divizionin e TI-së, ndarja jo e qartë e detyrave si dhe

mungesa e strukturave të duhura organizative, ndikon në transparencën dhe llogaridhënien e ndërmarrjes. Çështja e dytë ka të bëjë lidhur me sigurinë e informacionit. Ndërmarrja nuk ka ndërmarrë masat dhe nuk ka zhvilluar mekanizmat e duhur, në mënyrë që të sigurojë se informacioni të mos ekspozohet ndaj komprometimit dhe zbulimeve të paautorizuara. Çështje të cilat i ka identifikua ZKA-ja janë: KRU Prishtina nuk ka bërë identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e rreziqeve, që ndërlidhen me sigurinë e informacionit. Po ashtu, përdoruesit e sistemeve të informacionit të KRU Prishtina, nuk janë të ndërgjegjësuar mjaftueshëm lidhur me sigurinë e informacionit, sulmet e mundshme kibernetike, si nga brenda apo nga jashtë, andaj ndërmarrja rrezikon që të jetë e ekspozuar ndaj zbulimeve të paautorizuara, ndërmarrja nuk ka regjistër të plotë të aseteve të TI-së, rreth gjysma e pajisjeve të TI-së të regjistruar në regjistrat e ndërmarrjes, nuk kanë përcaktuar zyrtarin përgjegjës si dhe nuk mbajnë informata që klasifikojnë asetin, bazuar në rëndësinë e pasurisë si dhe të sigurisë.

Çështje tjetër: Kompleksiteti i fjalëkalimit nuk është vendosur në të gjitha Sistemet e informacionit të KRU Prishtina. Aplikacioni i faturimit nuk ofron siguri në autentifikimin e llogarive dhe lejon që përdoruesit për llogaritë/ID e tyre të përdorin fjalëkalim me gjatësi vetëm një karakter. Gjithashtu, ky aplikacion nuk ka funksion që detyron që shfrytëzuesit të ndërrojnë fjalëkalimet në periudha të rregullta. Për më tepër, për qasje në bazën e të dhënave përdoren llogaritë me qasje të plota të administratorit, të cilat nuk janë të personalizuar. Po ashtu, zyrtarët që kanë qasje të plota në bazat e të dhënave kanë qasje të plota edhe në aplikacione. KRU-ja nuk ka një metodologji/matricë të dhënies së qasjeve në resurset e ndryshme të teknologjisë informative. Çështje tjetër e identifikuar është se ndërmarrja nuk ka siguri të mjaftueshme, se mund të vazhdojë operimin e saj duke përdorur teknologjinë e informacionit dhe asetet e saj, në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore apo të ngjashme. Mungesa e masave parandaluese si dhe kontroleve në ambientin ku ruhen të dhënat, rrit rrezikun e qasjeve të paautorizuara, humbjen, dëmtimin, apo kërcënimet tjera. Çështjet e identifikuar lidhur me planin e vazhdimësisë janë prezantuar nga ZKA-ja si më poshtë:

KRU Prishtina, nuk ka krijuar mekanizmat parandalues kundrejt rreziqeve fizike dhe mjedisore në ambientet ku ruhet informacioni i ndërmarrjes.

KRU Prishtina, nuk ka plan të vazhdimësisë së proceseve të punës në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore apo dëmtime të tjera të sistemeve të informacionit. Kontrollat hyrëse të aplikacionit nuk janë të vendosura krahas rregullave të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), duke lejuar të futen të dhëna jo të sakta dhe të plota si dhe mungon ndërlidhja mes sistemeve, pra në mes të Agjencisë së Regjistrat Civil dhe Agjencisë së Regjistrat të Biznese. Çështjet e identifikuar lidhur me kontrollat hyrëse janë paraqitur më poshtë nga ZKA-ja: Nga aplikacionet që përdorë KRU Prishtina, kishte mungesë të vendosjes së kontroleve të vlefshmërisë gjatë vendosjes së të dhënave. Nga testimet në aplikacionin “Dynamic NAV”, në modulet për regjistrimin e pagave, aplikacioni lejonte futjen e një punëtori me numër të letërnjoftimit gabim dhe të pa verifikuar, me llogari bankare joekzistuese, apo të një banke tjetër, me një ditëlindje, data e së cilës nuk kishe ndodhur ende, çështje kjo për të cilën duam sqarime. Të dhënat në aplikacionet e KRU Prishtina nuk janë cilësore si dhe mungon ndërlidhja në mes të aplikacioneve. Nga analizimi i bazës së të dhënave, nga 176,814 konsumatorë të regjistruar

deri në fund të vitit 2022, janë identifikuar mangësitë si në vijim: 71,732 konsumatorë aktiv nuk kishin të regjistruar fare numër identifikues (numër personal, numër fiskal, numër të biznesit etj.), një shifër mjaft e lartë. Kishte po ashtu, raste kur në vend të ID-së ishin të regjistruar numra të telefonit, adresa elektronike apo të tjera. Çështje tjetër është se: rreth 4000 numra personal të regjistruar më shumë se dy herë në sistem që përmbajnë emër dhe mbiemër ndryshe, gjë që e pamundëson identifikim e saktë të poseduesit të ujëmatësve. KRU Prishtina nuk ka monitorim të sistemeve të informacionit dhe mungesa e rregullt e monitorimit të gjurmëve të auditimit shmang identifikimin me kohë të aktiviteteve jonormale, gabimeve, keqpërdorimeve të mundshme, apo mos identifikimin fare të tyre, të cilat mund të kenë efekt financiar dhe gjithashtu ekspozim të informacionit të paautorizuar. Kjo krijon një sistem të pasigurt dhe të cenueshëm kundrejt gabimeve dhe keqpërdorimeve të mundshme.

Prandaj, në bazë të të gjeturave të cilat janë evidentuar nga ZKA-ja, e cila ka dhënë gjithsej 18 rekomandime dhe në bazë të nënshkrimit nga KRU Prishtina, ju këtë raport e keni pranuar më 7.4.2023 dhe keni pasur kohë të mjaftueshme që sot të na jepni përgjigje në lidhje me këto të gjetura të cilat janë identifikuar. Njëjtë kemi dhe raportin tjetër, i cili na ka dhënë një bazë të mirë , e ku qëndrojmë, në krahasim me Shqipërinë, prandaj është punë për vlerësim dhe falënderojmë ZKA-në.

Hykeme Bajrami, kryetare e komisionit: Faleminderit e nderuar deputete, për të gjitha se çfarë deputetja raportuese ngriti si përmbledhje të raportit, fjalën e kaloj te kryesuesi i Bordit të KRU Prishtina, z. Bashkim Pllana. Fokusi në raportin e auditorit është te fragjiliteti i tërë sistemit, por ajo se çfarë kemi parë nga raportet dhe kompanitë e tjera, është diskrepanca e madhe në mes të ujit të shkarkuar, faturuar, paguar etj. Në interes timin personal është se sa përdoren këto aplikacione për ta zvogëluar këtë gabim mjaft të madh, i cili paraqet humbje financiare, por edhe humbje të resurseve ujore për kompaninë dhe vendin në përgjithësi.

Bashkim Pllana: KRU Prishtina këtë raport e ka pranuar javën e parë të muajit prill të vitit 2023. Të gjithë të pranishmit dhe të punësuarit në KRU Prishtina, duke përfshi bordin kanë pranuar raportin e auditorit dhe janë marrë me përgjegjësi të madhe të gjitha rekomandimet që përmban ky raport, dhe po mundohemi ta implementojmë në vazhdimësi. Departamenti i TI-së që nga muaji i 10-të i vitit 2023 ka përgatitur një dokument zyrtar për politikat dhe për procedurat e punësimit brenda departamentit, njëkohësisht në fillim të vitit 2024, ka përgatitur një strategji për shmangien e problemeve të gjetura nga ZKA-ja. Andaj janë alokuar mjete të nevojshme për korrigjimin, çështje teknike të cilat lidhen drejtpërdrejt me investimin në teknologji. KRU Prishtina, brenda rregulloreve të brendshme për sistematizimin e punës, ka të determinuar përgjegjësinë e çdonjërit në departamentin e TI-së dhe në kontratën e punës dhe në rregulloren për sistematizim janë bërë të gjitha kushtet të cilat duhet plotësuar nga secili departament. Ne kemi trajnime dhe certifikime në bazë të njohurive. Në vitin 2024, të gjitha kërkesat që janë bërë nga departamenti janë plotësuar dhe janë implementuar. Departamenti i TI-së në KRU Prishtina ka krijuar një strategji për vitin 2024/26 do jenë të inkorporuara të gjitha këto mangësi të gjetura nga zyrtarët e ZKA-së. Të gjitha këto çështje janë marrë me seriozitet për të gjetur zgjidhje. KRU Prishtina ka bërë investime në server ka vendosur dhe roje fizike përheq atyre teknologjike. Kemi bërë një databazë të sigurt duke dal dhe jashtë shtetit, tash për tash nuk ka ndonjë rrezik ndaj

sulmeve kibernetike apo dukurive natyrore. Ka rritje në nivelin e fjalëkalimeve të shumëfishta apo alfa numerike është kombinim i fjalëve dhe shkronjave duke përfshirë karaktere të ndryshme.

Hykeme Bajrami: Kryetar, kur po flasim për fjalëkalimet, për cilat fjalëkalime e keni fjalën, fjalëkalimin e kujt?

Bashkim Pllana: Po kryetare, kemi të bëjmë me fjalëkalime të sistemi softuer, dhe për të gjitha pajisjet të cilat janë të inkorporuara te Departamenti i TI-së.

Hykeme Bajrami: Në bazë të raportit unë mendoj se ju çaloni në aspektin e përparimit teknologjik. Ajo se çfarë më intereson është se sa janë borxhet e qytetarëve ndaj KRU Prishtina? Ju e keni bërë sistemin e faturimit në vitin 2013/14, në të cilën keni investuar 209 mijë euro, të gjitha sistemet e tjera janë sisteme të mirëmbajtjes, prej së cilës kanë kaluar 10 vite. Furnizimi me pajisje mobile dhe aplikacionit për lexim të ujëmatësve dhe faturimit të ujit, në bazë të kësaj, kur keni për të vendos ora digjitale për faturimin e ujit, ku dhe qytetarët do të paguajnë në bazë të shpenzimit të litrave të ujit? Si do të saktësohen humbjet teknike? A është bërë rregullimi i 4000 mijë numrave personal? Kur flasim për sigurinë e të dhënave, a është e mbrojtur qasja në të dhënat e klientit, pasi që mundet dikush të hyjë dhe të i fshijë të gjitha borxhet, dhe kur thoni që ka qasje vetëm një person në këto të dhëna, unë mendoj se hallka do të ishte më e mirë, nëse fjalëkalimi do duhej të kalojë në disa persona, sepse nuk mund të krijojmë sisteme të institucioneve, duke u bazuar në besueshmërinë e një personi. Këto janë disa çështje me interes për t'u qartësuar.

Mirlinda Tishukaj -Sadiku: Ka pasur dhe 12 e-mail adresa, të punëtorëve, të cilat kanë qenë ende aktive edhe pse ata punëtorë nuk kanë qenë më pjesë e stafit të KRU Prishtina edhe pas 12 muajsh. Kjo është mjaft brengosëse për sigurinë e informacionit dhe të dhënave.

Bashkim Pllana: KRU Prishtina ka instaluar Office 365 të cilën kanë të drejtë vetëm të punësuarit e KRU Prishtina të kenë qasje. Çdo shënim, ndërhyrje do të lexohet. Fusha më problematike momentalisht për KRU Prishtina, është siguri i objektit, jemi duke implementuar një projekt për administratën e KRU Prishtina, në të cilën do të hyjë dhe departamenti i TI-së, ku do të ketë një mbrojtje të lartë të sigurisë fizike. KRU Prishtina operon me rregulloret e ARU-së ku nga kjo e fundit me rregulloret e saj për çdo konsumator brenda 10 viteve duhet të ndërrohen ujëmatësit. Ujëmatësit me lexim nga distanca janë aparatura që momentalisht janë të papërballueshme nga aspekti i kostos të KRU Prishtina. Kemi nënshkruar një konsulencë me një kompani gjermane, kemi konsulencë shoqëruese dhe konsulencë për implementimin e projektit. KRU Prishtina ka humbje të ujit të pafaturuar, humbje aparente dhe teknike në total rreth 54%.

Mirlinda Tishukaj -Sadiku: Në bazë të raportit nga ZKA-ja, është 57% të humbjes së ujit.

Hykeme Bajrami: Kjo përqindje e humbjes a është me faturim apo me inkasim?

Bashkim Pllana: Përqindja është e pafaturuar, sepse inkasimi ka të bëjë me diçka tjetër.

Hykeme Bajrami: Kjo nënkupton që inkasimi është më i ulët se sa faturimi.

Bashkim Pllana: Ajo pjesa e cila inkasohet, faturimi është mbi 105%. Ne kemi bërë riprogramimin e borxheve dhe kemi ofruar mundësi të gjithë atyre të cilët kanë borxhe të vjetra, ta kenë mundësinë të bëjnë pagesë.

Hykeme Bajrami: 105% është një keqinterpretim nga ana juaj, sepse nëse unë kam një borxh të vjetër, nëse e paguaj sot, nuk i bie se po paguaj 105% por i bie se po e paguaj 100% të faturës. Dhe vlera 57%, e humbjes është mjaft e madhe dhe shqetësuese.

Bashkim Pllana: Ju paguani faturën dhe një pjesë të borxhit, inkasimi është rritur. Në BE kemi informata se uji teknik i humbur, është diku rreth 30% dhe KRU Prishtina ka në menaxhim rreth 1340 km gyp nëntokësor, kjo është sfiduese sepse kërkon kuadër dhe mjete për menaxhimin e duhur të zvogëlimit të ujit të pafaturuar. Sa i përket numrit të njëjtë të ID-ve, kjo është diskutuar në kuadër të bordit udhëheqës dhe është po ashtu sfiduese.

Mirlinda Tishkuaj- Sadiku: Në raportin zyrtar, të publikuar nga ARRU-ja, Austria ka 15%, Polonia 25%, Finlanda 17%, Belgjika 19% të humbjes së ujit teknik, nëse i referohemi shteteve të Bashkimit Evropian, ne jemi shumë larg në këtë aspekt. Ky problem paraqitet edhe te Bifurkacioni dhe Hidromorava, por 57% është vlerë e madhe, sepse ju mbuloni 8 komuna.

Bashkim Pllana: Ka gypa nëntokësorë të cilët janë mjaft sfidues për detektim dhe kontrollim.

Hykeme Bajrami: Ne shohim çdo ditë gypa në qytet në të cilat ka rrjedhje të ujit 24h dhe askush nuk ballafaqohet për zgjidhjen e problemit të tyre. Këto janë çështje mjaft serioze. Kosova në krahasim me vendet e rajonit është më e varfër sa i përket ujit të pijshëm dhe këtu i referohem Këshillit Ndërmintorë, i cili merret me ujërat dhe resurset, kjo çështje duhet të merret seriozisht dhe duhet të kemi evidentim të këtyre humbjeve të ujit.

Bashkim Pllana: Brenda 23 viteve kemi arritur të bëjmë zëvendësimin e të gjithë rrjetit të gypave dhe ujëmatësit për klientët. KRU Prishtina ka një dinamik të brendshme, pritet implementimi i disa projekteve për trajtimin e ujërave të zeza brenda Komunës së Prishtinës, Fushë -Kosovës, Obiliqit dhe Graçanicës. Vullneti për KRU Prishtina është i lartë dhe ne po mundohemi për të gjetur zgjidhjen e problemeve aktuale.

Mirlinda Tishukaj -Sadiku: Nga 18 rekomandime të evidentuara para 1 viti nga ZKA-ja, sa prej tyre në përqindje janë adresuar dhe realizuar? A sheh përparim KRU Prishtina edhe pas 3 viteve, sepse nëse prapë qëndrojnë këto të gjetura edhe pas 3 viteve këtu ka ngecje në aspektin implementues dhe financiar.

Bashkim Pllana: 1. Qeverisja e sistemit të TI-së – 100%, 2. Planifikimi strategjik 80%, 3. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësi – 100%, 4. Hartimi i politikave dhe procedurat e TI-së – 90%, 5. Mekanizmat për vlerësimin e rrezikut të sigurisë së informacionit – 90%, 6. Regjistri i saktë i të punësuarve të KRU Prishtinës – 85%, 7. Regjistrimi jo i duhur në bazë të kategorisë, 8. Komplexiteti i fjalëkalimeve, 9. Menaxhimi i llogarive të sistemit të informacionit – 100%, 10. Parandalimi i rreziqeve fizike – 50%, 11. KRU Prishtina, nuk ka plan të vazhdimësisë së proceseve të punës në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore apo dëmtime tjera të sistemeve të informacionit, 12. Të dhënat në aplikacionet e KRU

Prishtinës nuk janë cilësore si dhe mungon ndërlidhja në mes të aplikacioneve – 100%, 13. KRU Prishtina nuk ka monitorim të aktiviteteve në sistemet e informacionit – 100%.

Hykeme Bajrami: Sa janë borxhet e qytetarëve dhe bizneseve ndaj KRU Prishtina? A ka autolarje në Prishtinë që e përdorin ujin e pijshëm?

Bashkim Pllana: Nëse dihet se ka përdorim të ujit të pijshëm në autolarje dhe të merren masa përmes vëzhgimit të lexueseve të ujit në përmbajtje. Deri tani nuk ka pasur evidentim të keqpërdorimit të ujit të pijshëm në autolarjet në Prishtinë.

Riza Spanca: Faleminderit kryesuese, sa i përket pyetjes për borxhet e akumuluar që nga paslufta borxhi aktual i akumuluar i konsumatorëve arrin vlerën 52 milionë, në vitin 2023 kemi pasur një normë të inkasimit të rritur në krahasim me periudhën e kaluar. Jemi duke ndërmarr hapa të duhur ligjor, shumica prej tyre janë nga amvisëria, rastet sociale dhe nga bizneset.

Hykeme Bajrami: Fjalën po e kaloj te deputeti Visar Korencia dhe pastaj te deputeti z. Rashit Qalaj për disa pyetje drejtuar KRU Prishtinës.

Visar Korenica: Sa anëtarë të bordit janë në KRU Prishtina?

Bashkim Pllana: Sot kemi ardhur vetëm unë në cilësinë e kryesuesit të bordit dhe zyrtari i thesarit dhe financave. Bordi ka 7 anëtarë së bashku me kryeshefin ekzekutiv.

Visar Korenica: Përse nuk janë prezent sot bordi në mbledhjen e KMFP? Ftesa ka shkuar për gjithë bordin.

Bashkim Pllana: Ne e kemi parë të përshtatshme që mbulimi nga ana ime dhe nga zyrtari i thesarit dhe financave është i mjaftueshëm për pikën të cilën kemi ardhur. Ftesa erdhi në adresën time dhe të kryeshefit dhe ka qenë e paraparë për datën 30.4.24, por ne kemi pasur një paraagjendë me mbledhjen dhe kemi kërkuar nga administrata për ndërrimin e datës së mbledhjes.

Visar Korenica: Për respekt të deputetëve anëtarë të komisionit, në të ardhmen kur bëhet ftesa nga komisioni për të gjithë bordin, duhet të jeni prezentë të gjithë. E rëndësishme do të ishte prezenca e kryeshefit ekzekutiv sot në mbledhje pasi ai do të mund të bënte dallimin në procedurat teknike. Prej 18 rekomandimeve, të cilat i ka përcjellë tek ju ZKA-ja, sa prej tyre janë zbatuar plotësisht dhe a është përcjellë te ZKA-ja plani i zbatimit të rekomandimeve?

Riza Spanca: Planin e zbatimit të rekomandimeve e kemi përcjellë brenda afatit tek Zyra Kombëtare e Auditimit, në raporte mujore. Më shumë së gjysma e këtyre rekomandimeve janë zbatuar 100%.

Myrvete Gashi Morina: Janë gjithsej 14 rekomandime nga ZKA-ja, por brenda tyre janë dhe 4 nënrekomandime, në total janë 18 rekomandime.

Visar Korenica: Gjysma e këtyre rekomandimeve janë të zbatuara, po pjesa tjetër e rekomandimeve kur do të zbatohen?

Riza Spanca: Pjesa tjetër pritet që në muajin Qershor të kalojë aprovimin nga bordi për strategjitë dhe procedurat, ku përmes tyre adresohen edhe 2 rekomandime. Pjesa tjetër deri në fund të këtij viti do duhej të zbatohen.

Mirlinda Tishukaj Sadiku: Sa është kostoja e planit të strategjisë?

Riza Spanca: Realisht nuk e kemi bërë ende kostimin e strategjisë sepse jemi duke bashkëpunuar me pjesën e TI-së, për mirëmbajtje dhe menaxhimin e strategjisë.

Visar Korenica: Duke pasur parasysh që nga viti 2013 deri në vitin 2022, janë shpenzuar diku rreth 950 mijë euro për sistemin e TI-së brenda institucionit dhe ky investim nuk ka qenë i mjaftueshëm që ky sistem të jetë funksional, dhe tani është trashëguar një sistem me defektet e sistemit. Për ne është e rëndësishme të dimë periudhën ku ju prisni që kjo të përfundojë sa i përket zbatimit të rekomandimeve, sepse shikohet dhe suksesi në fund për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve. Sa pritet të shpenzohet ndërmarrja për këtë periudhë të zbatimit të implementimit të këtyre rekomandimeve?

Riza Spanca: Vlerën e saktësuar për investim nuk e kemi, sepse duhet të bëhen prioritizime se ku ka nevojë më shumë për investim dhe se cilat fusha mund të i mbulojmë me mjetet që veç i kemi aktualisht. Një shumë të caktuar nuk mund ta japim.

Visar Korenica: Dyfishimi i të dhënave mbi 4000 përdorues dhe qasja e lehtë në fjalëkalime, këto probleme të evidentuara kanë shkaktuar probleme financiare për vetë institucionin në funksionimin normal të saj. Këto probleme të cilat janë paraqitur a pritni që të përfundojnë pas implementimit të rekomandimeve?

Riza Spanca: Nëse procedura e rekrutimit për siguri të informacionit përfundon sipas parashikimeve të vitit, pjesa tjetër e rekomandimeve deri në fund të vitit do të jenë të implementuara përveç databazës së konsumatorëve e cila është mjaft çështje e ndjeshme.

Visar Korenica: Në lidhje me këtë, a ju lejon ligji të përdorni informacione nga një burimi i dytë siç janë institucionet publike të shtetit të Kosovës, shembull Agjencia e Regjistrimit Civil të cilët kanë informacione për qytetarët e Kosovës dhe pastaj ju vetë t'i regjistroni në sistemin e juaj.

Riza Spanca: Nuk i kemi të identifikuar rastet sociale edhe pse i kemi kërkuar nga institucioni publik.

Visar Korenica: Ideja është që të bëhet një hap proaktivë nga ana e KRU Prishtina, të nxjerrë të dhëna relevante të lejuara me ligj dhe të bëhet regjistrimi i tyre në sistem.

Rashit Qalaj: Fillimisht pajtohem me vërejtjen e adresuar nga deputeti Korenica, është dashur të jenë pjesëtarë tjerë të bordit të KRU Prishtina, për raportimin e pjesës teknike. Një raport i dobishëm për identifikimin e mangësive në KRU Prishtina dhe ky raport ndihmon në fushën e teknologjisë informative për investimet dhe përparimet të cilat duhen bërë në këtë drejtim. Problem është pjesa e menaxhimit të të dhënave dhe databazat. Mangësia e cila paraqitet në databazat e punonjëse të KRU Prishtina, është çështje e cila do të duhej të ishte zgjidhur që nga viti 2003 dhe kjo është pikë elementare e funksionimit të ndërmarrjes. Me rëndësi është përmbushja e rekomandimit dhe serioziteti në të. Në

Kosovë e kemi problem mbajtjen e punëtorëve në sektorin e TI-së për arsye të ndryshme. Për mua është e pakuptimit që punonjësi i KRU Prishtina të mos ketë adresën personale elektronike, sepse gjurmimi për gabime është më i lehtë, kurse në adresat kolektive ky gjurmim është më i vështirë. Pjesa teknike në KRU Prishtina e ka rëndësinë e lartë. Kërkesë e imja është që rekomandimet e dhëna nga ZKA-ja të përmbushen sa më shpejtë të jetë e mundur dhe 100% të realizohen.

Yllza Hoti: Faleminderit kryetare, përshëndetje për përfaqësuesit e KRU Prishtina dhe për ZKA-në. Pyetja ime ka të bëjë me sistemin e vjetër të faturimit dhe sistemin e ri të faturimit, të cilën e keni zhvillu sipas raportit nga ZKA-ja në vitin 2018, por që ende nuk është në funksion. Pasi që ende nuk përdoret sistemi i ri i faturimit, sistemi i vjetër ka kosto të mirëmbajtjes, ndërkaq investimi është bërë për sistemin e ri. Cila është arsyeja e moshyrjes në funksion të sistemit të ri të faturimit? Tash bëhen dy vite që nga zhvillimi i aplikacionit në telefon për pagesa online, gjithashtu dhe përmes e-Kosova. A ka ndonjë analizë nëse ky zhvillim ka ndikuar në përmirësimin e pagesave të borxheve nga qytetarët?

Riza Spanca: Domosdo kjo ka ndikuar në ngritjen e inkasimit në krahasim me faturimin dhe i bie që ka pasur efekt në këtë aspekt. Sistemi i vjetër ka përmbajtur disa module ku sistemi i ri nuk i ka përmbajtur, ku dhe departamenti i TI-së është duke bërë bartjen e këtyre moduleve.

Myrvete Gashi Morina: Një sqarim sa i përket auditimit paralel. Ky auditim është kryer në bashkëpunim me kontrollin e lartë të shtetit të Shqipërisë, ku ata kanë marrë ujësjellësin e Tiranës ndërsa ne atë të Prishtinës. Metodologjia ka qenë e njëjtë për përfundimin e këtij auditimi, janë bërë 5 vizita të përbashkëta dhe si rezultat i këtij auditimi individual është kryer auditimi, apo raporti i përbashkët ndërmjet dy institucioneve.

Halil Thaqi: Duke e marrë për bazë që kompanitë regjionale kanë problem me pagesa të punëtorëve, unë kam një pyetje në lidhje me pagat e punëtorëve dhe a ka investime të reja në rrjetin e ujësjellësit?

Bashkim Pllana: Që nga fillimi i vitit nuk kam hasur probleme në pagesa ndaj të punësuarve dhe operatorëve ekonomikë. KRU Prishtina pagën minimale e ka 500 euro bruto. KRU Prishtina ka investuar në komunën e Shtimes, ku ka 100% qasje në ujin e pijshëm dhe investime të tjera të parapara.

4. Shyrtimi i Raportit të përbashkët në auditimin paralel – “Sistemet e Informacionit në Ujësjellësit e Tiranës dhe Prishtinës”.

Hykente Bajrami, kryetare e komisionit: Deputetja z. Sadiku në përgjegjësinë e deputetes raportuese do të bëjë një përmbledhje të shkurtë në mes të krahasimit se ku gjendet KRU Prishtina me ujësjellësin e Tiranës.

Mirlinda Tishukaj -Sadiku: ZKA-ja ka bërë një lloj raporti të tillë dhe është hera e parë që ne si komision e shqyrtojmë, pritshmëritë e mia kanë qenë që shteti amë Shqiptarë do të qëndrojë shumë më mirë se shteti i Kosovës. Të gjeturat të cilat janë evidentuar te Kompania rajonale Prishtina përafërsisht janë të njëjta me atë të Tiranës. Këta të fundit nuk disponojnë strategji institucionale mbi teknologjinë e informacionit, kanë mungesë të vendosjes së prioritetit të institucionit, politikat për përmirësim të infrastrukturës,

teknologjisë informative po ashtu dhe gjurmët elektronike të auditimit nuk janë të plota për përdoruesit dhe punonjësit e atij institucioni që e aksesojnë sistemin. Puna në sistemin informatikë zhvillohet në mungesë të rregulloreve mbi përdorimin e sistemit. Nuk është kryer një monitorim efektiv i zbatimit të kontratave të aksesimit të informacionit nga palët e treta. Nëse bëjmë krahasimin në mes dy shteteve në lidhje me sistemet e informacionit në ujësjellësin e Tiranës dhe Prishtinës, ne nuk qëndrojmë larg njëra -tjetrës në bazë të të gjeturave nga ZKA-ja. Unë kam një pyetje në interes publik. E di që KRU Prishtina menaxhon 8 komuna, duke përfshirë Drenasin, dhe së fundmi kishim një zjarr të madh në një fabrikë në zonën ekonomike ku humbjet janë serioze. Si qëndron puna me hidrantët e ujit?

Bashkim Pllana: Parqet e bizneseve janë me rrezikshmëri të lartë të operimit dhe uji i fabrikuar nuk përdoret për këto çështje sepse ka kosto të lartë. Sistemi i ujit është komponentë kryesore e çdo infrastrukture përcjellëse dhe sistemi i ujit në raste të katastrofave që mund të ndodhin nga zjarri.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Ju faleminderit të gjithëve për diskutimin dhe KRU Prishtina dhe ZKA-në.

5. Të ndryshme

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Kemi pikën 5, ku, komisioni duhet të vendos, nëse Raporti auditimit të Performancës: “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës”; do të adresohet për në seancë plenare, bashkë me rekomandimet e propozuara nga komisioni, apo do të mbetet në nivel të komisionit. Po ashtu, komisioni duhet të vendos edhe për adresimin e raportit që e patëm sot në shqyrtim. Por siç po shihet, kemi mungesë të kuorumit, andaj edhe po e mbyllim këtë mbledhje për sot.

Për takimin e radhës do të njoftoheni me kohë.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Hykmete Bajrami,

Kryetare e Komisionit